



Albania  
Investment  
Council

Improving Transparency and Investment Climate

**KËSHILLI I  
INVESTIMEVE**

# RAPORT MONITORIMI I **REKOMANDIMEVE**

---

Janar - Dhjetor 2020

**KËSHILLI I INVESTIMEVE** është një platformë e ngritur nga autoritetet shqiptare me mbështetjen e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) me synim intensifikimin e dialogut mes qeverisë dhe sektorit privat, përmirësimin e klimës së biznesit dhe promovimin e mirë qeverisjes. Platforma mbështetet nga një sekretariat i përbërë prej një grupi të pavarur profesionistësh të zgjedhur dhe kontraktuar nga BERZH për t'u angazhuar drejtpërdrejtë me komunitetin e biznesit. Financimi aktual për Sekretariatit e KI, sigurohet nga Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO).

Informacioni i përmbledhur në këtë raport është përpiluar bazuar në qëndrimet e autorit dhe ekipit të sekretariatit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e BERZH-it apo SECO-s.

Materiali qoftë tekst apo imazh, nuk mund të përdoret për ndonjë qëllim tjetër përveç atij të specifikuar në të.

**TIRANË, JANAR 2021**

**Sekretariati i Këshillit të Investimeve - Staf**

Puna e Këshillit të Investimeve mbështetet nga Sekretariati, një organ i pavarur me profesionistë të përzgjedhur dhe kontraktuar nga BERZH për t'u angazhuar drejtpërsëdrejti me komunitetin e biznesit.

**Dr. Diana Leka (Angoni)**  
Drejtoresh e Sekretariatit  
lekad@investment.com.al

**Elvis Zerva**  
Ekspert Ligjor dhe Rregullator  
zervae@investment.com.al


**Elida Fara**  
Eksperte Ekonomie  
farae@investment.com.al

**Xaira Shurdha**  
Eksperte për Monitorimin dhe Bashkëpunimin  
shurdhax@investment.com.al

**Elisa Lula**  
Oficere Administrative dhe Komunikimi  
lulae@investment.com.al

Publikuar nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve (SKI), Dëshmorët e Kombit, Tiranë, Shqipëri  
info@investment.com.al / www.investment.com.al / SKI është përgjegjës për përmbajtjen e këtij publikimi.

f Albania Investment Council | ALInvestCouncil | Albania Investment Council



Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO

Këshilli i Investimeve mbështetet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, BERZH dhe Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështje Ekonomike (SECO).



**KËSHILLI I  
INVESTIMEVE**

**RAPORT MONITORIMI I  
REKOMANDIMEVE**

JANAR-DHJETOR 2020

# PËRMBAJTJA

<b>01   Përmbledhje Ekzekutive</b>	F. 06-08
<b>02   Metodologjia</b>	F. 09-10
<b>03   Konteksti</b>	F. 11-12
<b>04   Progresi i rekomandimeve</b>	F. 13-26
4.1 Progres i Rekomandimeve 2015-2020	13
4.2 Ndërhyrje të tjera të nevojshme	16
4.3 Iniciativa të ndërmarra nga Sekretariati i KI	17
4.4 Ecuria e rekomandimeve gjatë 2020	19
<b>05   Sfida dhe limitime</b>	F. 27
<b>06   Shtojca 1</b>	F. 28-29

## SHKURTIME

**BERZH** – Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim  
**KI** – Këshilli i Investimeve  
**SKI** – Sekretariati i Këshillit të Investimeve  
**MFE** – Ministria e Financës dhe Ekonomisë  
**SECO** – Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike  
**EU** – Bashkimi Evropian  
**EC** - Komisioni Evropian  
**EUD** - Delegacioni Evropian  
**QSH** – Qeveria e Shqipërisë  
**MTM** - Ministria e Turizmit dhe Mjedisit  
**MIE** – Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë  
**MBZHR** –Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural  
**AIDA** –Agjencia Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve  
**MASR** – Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve  
**MEPJ** – Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme  
**MSHMS** –Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale  
**ASHK** - Agjencia Shtetërore e Kadastrës  
**AZHT** – Agjencia e Zhvillimit Territorial  
**VKM** – Vendim i Këshillit të Ministrave  
**TIK** – Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit  
**KM**- Këshilli i Ministrave  
**DPT** – Drejtoria e Përgjithshme e Taksave  
**ABSA** –Shoqata Shqiptare e Shërbimeve të Biznesit  
**ERE** – Bordi Rregullator i Energjisë



01

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

**N**ë pesë vite të funksionimit të tij, Këshilli i Investimeve ka lëshuar 245 rekomandime në total, 38% e tyre aktualisht të zbatuara (në një masë 70-100%) dhe 14% në proces zbatimi. Edhe pse në kushte të distancimit social që nga Mars 2020, KI u mbledh katër herë duke u drejtuar nga Ministri i Financës dhe Ekonomisë dhe duke bashkëvepruar aktivisht me anëtarët e palët e tjera të përfshira, bazuar në punën analitike të ndërmarrë nga Sekretariati. Në këto mbledhje, u diskutuan kryesisht:

**(i)** përmirësimi i bashkëpunimit Bashki-Biznes në drejtim të rritjes së transparencës, shërbimeve dhe zhvillimit ekonomik lokal;

**(ii)** ndikimi i Covid-19 tek komuniteti i biznesit si dhe në një mbledhje të dedikuar u konsideruan sugjerimet kryesore të sjella nga bizneset për rimëkëmbjen ekonomike të vendit pas COVID-19

**(iii)** stimulimi i potencialeve për investime në agropërpunim me qëllim rritjen e vlerës së shtuar në vend, veçanërisht pas situatës nga Covid19 që nxori në pah brishtësinë e zinxhirëve të furnizimit.

Lidhur me temat e mësipërme, Sekretariati i KI përgatiti dhe prezantoi 49 rekomandime bazuar në (i) hulumtime të raporteve kombëtare dhe ndërkombëtare, (ii) propozime nga grupet e punës dhe takimet me përfaqësues e ekspertë të sektorit privat, (iii) analiza të dhënash nga survejimet e SKI (iv) komentet dhe sugjerimet e anëtarëve që konkretisht propozuan 8 rekomandime shtesë gjatë mbledhjeve. Kështu në total janë 57 rekomandime të lëshuara dhe aprovuara nga kryetari i KI, anëtarët dhe institucionet përgjegjëse, gjatë këtij viti.

Nga aktivitetet e monitorimit, rezulton se në vitin 2020, janë plotësuar 25 rekomandime në një masë 70-100% dhe 13 rekomandime janë aktualisht në zbatim. Nga këto 38 rekomandime të marra në konsideratë nga institucionet zbatuese, 8 janë rekomandime të propozuara gjatë mbledhjeve të mbajtura në vitin 2020. Kjo reflekton një rritje të shpejtësisë së implementimit të rekomandimeve krahasuar me vitet e mëparshme.

Ecure mirë gjatë këtij viti, është evidentuar në drejtim të përmbushjes së rekomandimeve në dy drejtime si (1) rritja e cilësisë së shërbimeve e kualifikimieve në sektorin BPO dhe (2) përmirësimet në platformën e-leje. Më konkretisht, në lidhje me aftësitë në sektorin e BPO, 24% e rekomandimeve totale janë përmbushur<sup>1</sup>, ndërsa 15% e rekomandimeve për të njëjtën temë (nga e njëjta mbledhje) janë në proces ndjekje. Hapa pozitivë u ndërmorën gjithashtu në drejtim të përmbushjes së rekomandimeve të lëshuara në mbledhjen për lejet e ndërtimit<sup>2</sup> në lidhje me përmirësimet e platformës online e-leje me një peshë rreth 24% të rekomandimeve të implementuara në vitin 2020.

Nga pikëpamja sektoriale, nga 25 rekomandimet e miratuara gjatë këtij viti, 18% i përkasin propozimeve të lëshuara në sektorin e TIK, gjë që thekson rëndësinë e këtij sektori sidomos gjatë situatës pandemike. 16% e rekomandimeve të marra në konsideratë (në 2020) lidhen me sektorin e Turizmit, pasuar nga rekomandimet në sektorin Bujqësor me 11% të rekomandimeve të miratuara nga institucionet qeveritare.

Fushat kryesore të ndërhyrjes ku rekomandimet e zbatuara stimuluan veprime konkrete nga institucionet kompetente gjatë vitit 2020, janë:

- 1) **Rritja e Punësimit dhe kapaciteteve të kapitalit njerëzor** - Katër VKM u miratuan gjatë vitit 2020 me synim stimulimin e punësimit, përmes subvencionimit të bizneseve me qëllim punësimin e trajnimit e punëkërkuarve të papunë. Përmes këtyre vendimeve, bizneseve u mundësohet subvencionimi i pagave dhe kontributeve shoqërore për një periudhë maksimumi një vit sipas disa specifikave të programeve të punësimit (përfshirë trajnime edhe për personat e vetëpunësuar të interesuar).
- 2) **Konkurrueshmëria e Sektorit të Turizmit** - përmirësimi i konkurrencës dhe formalizimit në sektor përmes identifikimit dhe klasifikimit të strukturave turistike si dhe përmes shtimit të konsultimeve me komunitetin e biznesit mbi hartimin e planeve lokale dhe kombëtare për investime publike në infrastrukturë në sektorin e turizmit.
- 3) **Avancimi i reformës së Derregullimit** - përmirësimi i cilësisë së shërbimeve online të ofruara përmes platformës elektronike për lejet e ndërtimit. Më specifikisht, janë unifikuar afatet për vendimmarrje për lejet e ndërtimit, është shmangur pezullimi i funksionalitetit të platformës, thjeshtuar lëshimi i lejes mjedisore për ndërtimet me nivel të ulët të ndikimit në mjedis, dhe është mirë përcaktuar roli/përgjegjësitë e institucioneve të ndërlidhura në platformë.

1 Referencë rekomandimeve të lëshuara në mbledhjen 9 të KI "Fuqia punëtore e kualifikuar, mundësi për investime", mbajtur në Shkurt 2017

2 Referencë mbledhja "Mbi funksionimin e platformës e-leje", mbajtur në Shkurt 2018

- 4) **Incentivimi përmes stimujve fiskalë** – nxitja e investimeve në sektorin e agro-prodhimit përmes subvencionimit të naftës për të gjithë fermerët të regjistruar me NIPT dhe që duke filluar nga Janari 2021, do të deklarohen në portalin online e-Albania detajet dhe specifikat e biznesit të tyre si p.sh. sasia e tokës në pronësi ose me qira, lloji i prodhimeve të mbjella, etj.
- 5) **Forcimi i sektorit BPO** – përmes përmirësimit të kapaciteteve të shoqatës ABSA (Shoqata Shqiptare e Shërbimeve të Biznesit) si institucion përfaqësues i këtij sektori. Përsheptimi i aktiviteteve të avokimit me institucionet publike dhe partnerët për zhvillim (si Risi Albania, SDC, AIDA, Harvard Center for Growth) në drejtim të (i) ngritjes së aftësive profesionale të punonjësve, (ii) krijimit të sindikatës së punonjësve të Pikave të shërbimeve online (Call center), (iii) promovimit të sektorit si një mundësi pozitive për investime përmes platformës së unifikuar Global Digit City, (iv) rishikimit të kornizës ligjore dhe (v) ndërmarrjes së veprimeve për të ulur informalitetin e sektorit.
- 6) **Përputhshmëria rregullatore** - kompletimi i kuadrit ligjor dhe rregullator si parakushte për inkurajimin e investimeve në sektorë të rëndësishëm siç janë komunikimet elektronike dhe sektori i energjisë së rinovueshme (p.sh. është mundësuar aprovimi i metodologjisë së përcaktimit të çmimit të blerjes së energjisë të prodhuar nga fotovoltajkët).
- 7) **Mbështetja e teknologjisë dhe inovacionit** - stimulimi i ekspozimit të popullatës ndaj potencialeve të TIK përmes bashkëpunimeve me bizneset. Konkretisht disa biznese<sup>3</sup> dhe partnerë për zhvillim subvencionuan kostot e pajisjeve dixhitale si laptopë, smartphone, etj. si pajisjet e para me të cilat njerëzit qasen në internet.
- 8) **Transparencë e incentivave** - rritja e transparencës dhe promovimi më i mirë i incentivave të ofruara në Shqipëri mbi baza sektoriale, informacion mbi skemat financiare në mbështetje të NVM-ve, udhëzimet dhe kornizës ligjore përkatëse nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), përmes faqes së saj të internetit.

Nga rekomandimet totale të lëshuara që nga viti 2015, aktualisht ka 117 rekomandime ende të paplotësuara nga institucionet përgjegjëse. Sidoqoftë, krahasuar me vitet e mëparshme, gjatë vitit 2020 kemi evidentuar mobilizim më të lartë dhe reagim më të shpejtë në lidhje me kohën e zbatimit të rekomandimeve.

## 02

# METODOLOGJIA

Informacion më i detajuar paraqitet në seksionet e mëposhtme të këtij raporti.

**K**y raport monitorimi synon të evidentojë ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KI të lëshuara gjatë viteve 2015-2020, dhe më specifikisht progresin e zbatimit të rekomandimeve gjatë vitit 2020. Përmbajtja e tij bazohet në të dhënat cilësore dhe sasore të mbledhura gjatë vitit 2020 nga aktivitetet e mëposhtme:

**I - Aktivitete monitoruese në ndërveprim me institucionet përgjegjëse:**

**(i)** Shkëmbimi zyrtar i informacionit përmes korrespondencave me shkrim pas çdo takimi të KI-së duke u adresuar institucioneve rekomandimet specifike që priten të zbatohen prej tyre;

**(ii)** Aktivitete monitoruese mbi nivelin e implementimit të rekomandimeve specifike në bazë tre mujore.

Këtë vit, për shkak të pandemisë Covid-19, takimet direkte janë kufizuar dhe komunikimi është bërë kryesisht përmes korrespondencës me shkrim, postave elektronike dhe telefonatave të shpeshta përmes platformës Skype, telefonit ose WhatsApp. Lista e institucioneve që raportuan zyrtarisht reagimet e tyre mbi përmbushjen ose jo të rekomandimeve respektive, është elaboruar në Shtojcën 1.

**II - Punë hulumtuese**

Përtej korrespondencës zyrtare, u konsultuan një sërë dokumentash zyrtare me qëllim identifikimin e ndryshimeve relevante e që lidheshin me progresin e zbatimit të rekomandimeve të KI. Më konkretisht dokumentet e konsultuara ishin (1) Vendime të KM, (2) Vendime të Ministrave, (3) Ligje, akte nënligjore (modifikimet e tyre), (4) strategji të aprovuara (5) plane veprimesh, (6) Raporte progresi të BE-së (7) dhe raportet ndërkombëtare (të tilla si Doing Business, raporte të konkurrenshëmërisë, etj.) Në Shtojcën 1 gjenden të listuara dokumentet kryesore të konsultuara.

### III – Burime dytësore informacioni

Një nga aktivitetet më të shpeshta është kontrolli në bazë ditore i faqeve të internetit, platformave, rrjeteve sociale e medias vizive, si një nga burimet e informacionit ku promovohen aktivitetet e ndërmarra nga institucionet publike, si dhe platforma konsultimesh, artikuj gazetash, njoftime për shtyp, lajme etj. Përveçse një mjet dytësor verifikimi informacioni mbi përmbushjen apo jo të rekomandimeve të KI, këto burime shërbejnë gjithashtu si matës i nivelit të transparencës së institucioneve zbatuese dhe nivelit të angazhimit të tyre me sektorin privat. Disa nga faqet e konsultuara janë renditur në Shtojcën 1.

### IV – Përpunim të dhënash

Çdo informacion i marrë nga komunikimi me institucionet, dokumentat justifikuese apo linqet e publikimeve, regjistrohen në databazën e rekomandimeve që është tashmë e ngritur. Kjo bazë të dhënash përditësohet me informacionet e reja që diskutohen me anëtarët e Sekretariatit të KI për dakordësim të statusit të rekomandimeve respektive. Në bazë tremujore, gjenerohet një raport situacional i ecurisë së rekomandimeve.

### V – Raportimi

Reflektimi i gjetjeve nga aktivitetet monitoruese dhe përditësimi i progresit u raportohet anëtarëve të KI në bazë gjashtëmujore. Për më tepër, këtë vit rezultatet vjetore të monitorimit u prezantuan në mbledhjen e fundit të KI për vitin 2020, tek anëtarët, partnerët e pjesëmarrësit e tjerë. Përmbledhje të statusit të zbatimit të rekomandimeve botohen gjithashtu në faqen e internetit të KI dhe mediat sociale.

### Parimet e Monitorimit<sup>4</sup>

Në ndjekjen e përmbushjes së rekomandimeve dhe gjatë gjithë aktiviteteve monitoruese, vlerat që na drejtojnë janë:

- o bashkëpunim i ndërsjellë me të gjithë aktorët, partnerët dhe institucionet qeveritare
- o transparencë e të dhënave dhe informacionit për anëtarët e KI, donatorët dhe palët e tjera të përfshira
- o konsultimi i të paktën dy burimeve të pavarura për të saktësuar informacionin e marrë
- o shkëmbime opinionesh, informacionesh, dialog mbi përditësimet dhe dakordësim i gjithë stafit të Sekretariatit mbi ecurinë e përmbushjes së rekomandimeve (*si nga ana cilësore ashtu edhe sasiore*)
- o argumentimi i rezultateve bazuar në të dhëna të faktuara në rrugë zyrtare

## KONTEKSTI

**K**ëshilli i Investimeve është një platformë dialogu publik-privat, që synon t'i japë sektorit privat më shumë zë e përfshirje në procesin e reformimit ekonomik dhe strukturor, gjithashtu duke u përpjekur të zhvillojë një mjedis biznesi të favorshëm, transparent dhe miqësor ndaj investimeve në të gjithë sektorët ekonomikë e në të gjithë vendin. Rezultatet e pritshme nga krijuesit e kësaj platforme janë:

**(i) KI të konsiderohet një strukturë e besueshme:** Si një platformë e strukturuar dialogu mes sektorit publik e atij privat, KI duhet të bazojë punën e tij në fakte dhe të gjenerojë besim mes të gjithë palëve të përfshira duke ndikuar në forcimin e ekonomisë shqiptare.

**(ii) KI të jetë një mjet efektiv reformues:** Qeveria dhe komuniteti i biznesit ta shohin e ta përdorin KI si një mjet efektiv për reformim të qëndrueshëm ekonomik.

**(iii) KI si përforcues i implementimit të reformave:** Përmbushja e rekomandimeve të KI të përforcohet edhe përmes projekteve mbështetëse për institucionet zbatuese.

**(iv) Nxitëse e investimeve** përmes shtytjes së uljes së barrës administrative e reduktimit të kostove të përputhshmërisë për bizneset, si dhe një qeverisje të përmirësuar në aspektin ekonomik.

Referuar pritshmërive nga KI si një mjet efektiv reformues, indikatorët kryesorë të matjes së performancës së tij lidhen me:

**(i)** Numrin e rekomandimeve të lëshuara për zbatim nga institucionet qeveritare

**(ii)** Numrin e propozimeve të KI mbi përmirësimin e klimës së investimeve, të aprovuara nga autoritetet përgjegjëse.

Kështu që, aktivitetet monitoruese për këtë raport janë përqëndruar në mbledhjen e të dhënave dhe analizën e informacionit që lidhen me këto dy indikatorë me qëllim që të:

(i) informojë palët e përfshira dhe t'i përditësojë ato mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve të lëshuara gjatë mbledhjeve të KI e më specifikisht gjatë vitit 2020

(ii) të sigurojë palët që ato çfarë janë propozuar janë marrë ose po merren në konsideratë

(iii) të mbështesë vendimmarrjen e donatorëve dhe menaxherëve përmes ofrimit të informacionit

### *Qëllimi i monitorimit*

Raporti mbulon gjithë periudhën e veprimtarisë së KI 2015-2020 duke qënë se disa rekomandime të lëshuara në vitet e mëparshme kërkojnë kohë për t'u përbushur, ndërsa rekomandimet e lëshuara gjatë vitit të kaluar kërkojnë kryesisht të paktën 6 muaj ose më shumë që të miratohen dhe përpunohen nga institucionet vendimarrëse. Prandaj, në seksionet e mëposhtme paraqitet një përmbledhje e rezultateve të periudhës pesë vjeçare dhe një pjesë specifike me ecurinë gjatë vitit 2020.

## PROGRESI I REKOMANDIMEVE

### 4.1 – Pasqyrë e rekomandimeve 2015-2020

**Q**ë nga fillimi i aktivitetit të tij, Këshilli i Investimeve ka organizuar 22 mbledhje duke adresuar në secilën prej tyre çështje specifike të biznesit. Me mjaft rëndësi është përfshirja e anëtarëve të KI në vlerësimin e temave që duhen diskutuar, ndarjen e komenteve dhe pikëpamjeve të tyre, problemet e identifikuar nga biznesi, zgjidhjet e mundshme si dhe sugjerimet e tyre specifike gjatë mbledhjeve. Kështu, mbi 245 rekomandime totale të dhëna gjatë 2015-2020 pesha e rekomandimeve të adresuara nga anëtarët e KI, është rreth 17%.


Ndërkohë që 83% e rekomandimeve të tjera janë lëshuar bazuar në një analizë e punë kërkimore paraprake të përgatitur nga ekipi i Sekretariatit të KI përmes (i) hulumtimesh mbi raportet kombëtare dhe ndërkombëtare, (ii) kontributet nga takimet e drejtpërdrejta me përfaqësuesit dhe ekspertët e sektorit privat, (iii) lehtësimin e grupeve të punës të organizuara në bashkëpunim me përfaqësuesit e institucioneve qeveritare, biznese e ekspertë, (iv) analizimin e të dhënave ngaurvejimet e SIK dhe (v) rekomandimet e ekspertëve. Deri më tani, të gjitha rekomandimet janë miratuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë që drejton KI si dhe nga anëtarët e institucionet përgjegjëse.

*Profili i rekomandimeve të lëshuara sipas temës.* Nga rekomandimet totale të lëshuara, theksojmë se numri më i madh i rekomandimeve janë lëshuar në dy mbledhje specifike si: (i) 29 rek. mbi “Modelin ekonomik, potencialin e investimeve dhe sektorët me përparësi (2019)” dhe (ii) 23 rek. në mbledhjen mbi “Rimëkëmbjen ekonomike pas pandemisë Covid-19”, mbështetur mbi rëndësinë e këtyre temave.

Më konkretisht, numri i rekomandimeve të dhëna në mbledhjet e KI paraqitet në tabelën më poshtë:



**Grafiku 1.** Numri i rekomandimeve sipas temës 2015-2020




Rekomandimet totale të adresuara në mbledhjet e KI (2015-2020), synojnë ndërhyrje në pesë nivele: (i) Strategjike, (ii) Institucionale, (iii) Ligjore (iv) Transparencë, dhe kategoria e fundit që e kemi shtuar gjatë këtij viti (v) Politika.

Aktivitetet e propozuara për tu ndërmarrë nën kategorinë e **përmirësimeve Institucionale**, zënë peshën më të lartë mbi totalin - 43%, ku theksi jepet kryesisht në:

- (i) bashkëpunimin ndërinstitucional
- (ii) ngritjen e kapaciteteve të strukturave operacionale
- (iii) qëndrueshmërinë e institucioneve
- (iv) rritjen e standartit dhe cilësisë së shërbimeve


Referuar gjithashtu të dhënave nga raporti i monitorimit i vitit 2019, kur krahasojmë trendin me shifrat e këtij viti, rekomandimet që synojnë ndërhyrjet në një nivel strategjik kanë një rritje prej 4%. Transparenca është një çështje e ngritur në 9% të rekomandimeve totale dhe pavarësisht rritjes së numrit të rekomandimeve, kjo përqindje është e njëjtë me vitin e kaluar.

**Grafik 2.** % e rekomandimeve sipas kategorisë



Aktualisht nga totali i rekomandimeve të lëshuara, 38% e tyre janë plotësuar dhe 14% janë në proces duke kërkuar më shumë kohë e përpjekje deri në zbatimin e plotë të tyre.

**Grafik 3.** Statusi i rekomandimeve 2015-2020 (në %)



Në kuadrin sektorial, 33% e total rekomandimeve të KI, adresojnë ndërhyrje në dy sektorët kryesorë si **Turizmi dhe Bujqësia** duke synuar kryesisht:


- (i) Rritje të nivelit të formalizimit të sektorëve
- (ii) Incentiva për forcimin e sektorëve
- (iii) Ndërhyrje ligjore që do lehtësonin bizneset e këtyre sektorëve
- (iv) Ndërmarrjen e incentivave me qëllim rritjen e vlerës së shtuar të investimeve në sektorin e Agro-përpunimit.



Sektori i BPO, i cili gjatë dy viteve të fundit ka pësuar shumë ndryshime në drejtim të formalizimit dhe strukturimit të tij, përbën 7% të rekomandimeve totale. Gjithashtu një peshë prej 7% zënë edhe rekomandimet e dhëna në drejtim të përmirësimeve të funksionalitetit të platformës elektronike e-lejet.

Referuar edhe të dhënave të raportit të monitorimit 2019, numri i rekomandimeve totale për sektorin Agro dhe nënsektorët, në vitin 2020 ka një rritje prej 14%, duke theksuar rëndësinë e sektorit në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, veçanërisht pas situatës pandemike.

**Grafik 4.** Total Rekomandimet sipas sektorit 2015-2020 (në %)



#### 4.2 Ndërhyrje të tjera të nevojshme


Aktualisht janë në total 117 rekomandime të paplotësuara nga institucionet përgjegjëse. Ndër ato më të rëndësishmet dhe ato ku duhen përqendruar më shumë përpjekjet nga institucionet qeveritare, mund të përmendim:

- (i) Përgatitja dhe miratimi i një Strategjie të mirëfilltë kundër ekonomisë informale
- (ii) Stabilizimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor fiskal
- (iii) Dixhitalizimi i regjistrave të disa institucioneve kyçe (si ASHK) që do lehtësonte barrën administrative
- (iv) Forcimi i bashkëpunimit mes inspektorateve dhe ndërmarrja e inspektimeve të përbashkëta
- (v) Përmirësimi i procesit të apelimeve që duhet të unifikohet për të gjithë inspektoratet

77% të totalit të rekomandimeve të paplotësuara, e zënë rekomandimet e lëshuara në gjashtë mbledhjet e mbajtura gjatë dy viteve të fundit 2019-2020. Kjo thekson faktin se institucioneve publike u duhet pak kohë për të marrë masa drejt procesit të zbatimit të tyre. Një peshë të konsiderueshme në totalin e rekomandimeve të pa përmbyshura, rreth 19%, e zënë rekomandimet e lëshuara në mbledhjen “Mbi potencialet e investimeve dhe sektorët prioritarë”.

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet numri i rekomandimeve të papërmbyshura (në %) detajuar sipas temave të diskutuara.

**Grafik 5.** Total Rekomandimet e papërmbyshura sipas temave 2015-2020 (në %)



#### 4.3 Iniciativa të ndërmarrja nga sekretariati i KI

Me kërkesë specifike të Kryetares së KI-së, znj. Denaj, dhe si rezultat i diskutimeve gjatë mbledhjeve, Sekretariati i KI koordinoi disa grupe formale pune duke përfshirë në përbërje të tyre anëtarë të institucioneve publike dhe ekspertë, dhe duke kërkuar suportin e partnerëve për zhvillim për të përshpejtuar procesin të zbatimit të rekomandimeve. U ndërmorrën disa takime konsultative për të përcaktuar rolet, përgjegjësitë, afatet kohore dhe planet e punës për tu ndjekur nga institucionet duke u adaptuar edhe nën kushtet e situatës pandemike. Disa nga veprimet e ndërmarrja ishin:

**(A) Koordinimi i pesë grupeve të punës në disa takime mbi:**

- 1) përmbyshjen e rekomandimeve të KI për përmirësime në sektorin e TIK, me pjesëmarrës kryesorë nga MFE dhe MIE;
- 2) përmbyshjen e rekomandimeve të përqendruara në sektorin agro dhe nënsektorët e tij, me pjesëmarrës kryesorë nga MFE dhe MBZHR;

- 3) përmbushjen e rekomandimeve të përqendruara në sektorin e energjisë, me pjesëmarrës kryesorë nga MFE dhe MIE;
- 4) përmbushjen e rekomandimeve mbi Bllokimin e Llogarive të Biznesit, me pjesëmarrës kryesorë nga MFE, Shoqatën e Bankave, Shoqatat e Biznesit, Dhomat e Tregtisë, Bashkinë e Tiranës;
- 5) diskutimin mbi problematikat e hasuara nga disa biznese në pesë Bashki, me pjesëmarrës kryesorë nga MFE, Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Biznesit, Shoqatat e Biznesit, Dhomat e Tregtisë, pesë Bashkitë në fjalë.

**(B)** Dy projekte asistence teknike u ndërmorën në bashkëpunim me BERZH dhe SECO, në mënyrë që të përmbushen pesë rekomandime të adresuara për MFE dhe AZHT.

#### *1- Asistencë teknike për Agjencinë e Zhvillimit të Territorit që synon përmirësimin e funksionalitetit dhe efektivitetit të platformës e-leje*

Në vijim të rekomandimeve të lëshuara nga KI për lehtësimin e të bërit biznes në fushën e lejeve të ndërtimit, me ndërmjetësimin e Sekretariatit, ekipi i BERZH diskutoi dhe ra dakord me Agjencinë e Zhvillimit të Territorit për një projekt të Asistencës Teknike që mbështet këtë institucion në fushat e mëposhtme:

- Vlerësimi i funksionalitetit të platformës e-leje, duke marrë parasysh metodologjinë e “Bërjes së Biznesit” të Bankës Botërore në vlerësimin e fushës së lejeve të ndërtimit;
- Përgatitja e një manuali dhe procedurave të unifikuara për të gjithë përdoruesit (publik dhe privat) të platformës;
- Ngritja e kapaciteteve institucionale dhe publikimi i informacionit për rritjen e ndërgjegjësimit rreth platformës;
- Përshpejtimi i procesit të vendimmarrjes në platformën e-leje përmes dixhitalizimit të mëtejshëm

#### *2- Asistencë Teknike për digjitalizimin e SME-ve*

Gjatë dy mbledhjeve të dedikuara impaktit të Covid-19 në Maj-Qershor 2020, Sekretariati në bashkëpunim me të gjithë anëtarët e KI, institucionet shtetërore, anëtarët e biznesit, shoqatat dhe partnerët ndërkombëtarë për zhvillim, ka luajtur një rol të rëndësishëm përmes reagimit të shpejtë për të propozuar zgjidhje në përgjigje të problematikave krijuar biznesit nga pandemia. Si çështje ndër-sektoriale, u theksua dukshëm nevoja për t'i dhënë përparësi dixhitalizimit dhe për të maksimizuar aksesin e bizneseve në Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK).

Pas miratimit të rekomandimeve të KI, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), kërkoi mbështetjen e BERZH (në bashkëpunim gjithashtu me Ministrinë e Infrastrukturës

dhe Energjisë dhe Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve), për suport teknik për zbatimin në veçanti të 2 prej rekomandimeve të adresuara këtij institucioni:

**(i)** Analizim i nevojave dhe propozim i hapave konkrete për përmirësimin e aksesit të NVM-ve në shërbimet e TIK-ut;

- vlerësimi i kërkesës për zgjidhje dixhitale nga NVM-të në të gjithë sektorët ekonomikë / rajonet me përparësi të vendit;

- vlerësimi i disponueshmërisë së produkteve të përshtatshme për të përmbushur nevojat e NVM-ve në sektorë jo-dixhitalë; dhe

- rekomandimi i mjeteve, mekanizmave dhe politikave të nevojshme që mund të adresojnë ato nevoja dhe mund të ndihmojnë NVM-të të shfrytëzojnë përfitimet nga TIK;

**(ii)** (ii) Përmirësimi dhe dixhitalizimi/centralizimi i informacionit mbi skemat e burimet ekzistuese dhe të ardhshme të financimit, si një mjet i rëndësishëm në internet për aksesin në financa të NVM-ve.

Rezultatet e këtij suporti teknik priten të finalizohen në Prill 2021.

#### **4.4 Ecuria e rekomandimeve gjatë 2020**

Gjatë katër mbledhjeve që u mbajtën gjatë vitit 2020, Sekretariati i KI përgatiti dhe prezantoi 49 rekomandime të reja, ndërsa anëtarët e KI propozuan edhe 8 rekomandime të tjera gjatë mbledhjeve. Rekomandimet e propozuara përqendroheshin kryesisht në: (i) përmirësimin e Ndërveprimit Bashki-Biznes në drejtim të Transparencës, Shërbimeve dhe Zhvillimit Ekonomik Lokal; (ii) sugjerimet kryesore të biznesit për rimëkëmbjen ekonomike të vendit pas Covid-19 dhe (iii) stimulimin e potencialeve për investime në agropërpunim me qëllim rritjen e vlerës së shtuar në vend, veçanërisht në kushtet kur kriza e koronavirusit ka theksuar edhe më shumë brishtësinë e zinxhirëve të furnizimit.

Nga aktivitetet e monitorimit, rezulton se gjatë vitit 2020 janë përmbushur 25 rekomandime dhe 13 janë në proces. Nga këto 38 rekomandime të marra në konsideratë nga institucionet zbatuese, 8 janë rekomandime të propozuara gjatë mbledhjeve të mbajtura në vitin 2020, ndërsa të tjerët janë rekomandime të viteve të mëparshme.


Ecuria e mirë gjatë këtij viti, është evidentuar në drejtim të përmbushjes së rekomandimeve në dy drejtime si (1) rritja e cilësisë së shërbimeve e kualifikimieve në sektorin BPO dhe (2) përmirësimet në platformën e-leje. Më konkretisht, në lidhje me aftësitë në sektorin e BPO, 24% e rekomandimeve totale janë përmbushur, ndërsa 15% e rekomandimeve për të njëjtën temë (nga e njëjta mbledhje) janë në proces ndjekje. Hapa pozitivë u ndërmorën gjithashtu në drejtim të përmbushjes së rekomandimeve të lëshuara në mbledhjen për lejet e ndërtimit në lidhje me përmirësimet e platformës online e-leje me një peshë rreth 24% të rekomandimeve të implementuara në vitin 2020.

Nga pikëpamja sektoriale, nga 25 rekomandimet e miratuara gjatë këtij viti, 18% i përkasin propozimeve të lëshuara në sektorin e TIK-ut, gjë që thekson rëndësinë e këtij sektori sidomos gjatë situatës pandemike. Një tjetër 16%-sh e rekomandimeve të marra në

konsideratë (në 2020) lidhen me sektorin e Turizmit, pasuar rekomandimet në sektorin Bujqësor me 11% të rekomandimeve të miratuara nga institucionet qeveritare.

Në grafikun e mëposhtëm, listohen rekomandimet e përmbushura dhe ato në proces gjatë këtij viti:

**Grafik 6.** Rekomandimet e përmbushura & në proces sipas temës gjatë 2020



Fushat kryesore të ndërhyrjes ku rekomandimet e zbatuara stimuluan veprime konkrete nga institucionet kompetente gjatë vitit 2020, janë:

- (i) Rritja e Punësimit dhe kapaciteteve të kapitalit njerëzor
- (ii) Konkurrueshmëria e Sektorit të Turizmit
- (iii) Avancimi i reformës së Derregullimit
- (iv) Incentivimi përmes stimujve fiskalë
- (v) Forcimi i sektorit BPO
- (vi) Përputhshmëria rregullatore
- (vii) Mbështetja e teknologjisë dhe inovacionit
- (viii) Transparencë e incentivave

Disa nga rekomandimet më të rëndësishme të KI dhe masat specifike të ndërmarra gjatë vitit 2020 për plotësimin e tyre, detajohen në tabelën më poshtë:

Fusha e ndërhyrjes	Rekomandimi	Arritja	Impakti i pritshëm
<b>1) Rritja e punësimit dhe kapaciteteve të kapitalit njerëzor</b>			
	Mbështetja e biznesit përmes skemave të subvencionimit të kontributeve sociale dhe shëndetësore për punonjësit me një kontratë më pak se një vit, ose prezantimi i programeve të trajnimit të punonjësve jashtë sezoneve (veçanërisht në sektorin e turizmit). Kjo do të përmirësojë rekrutimin dhe cilësinë e stafit, siç kërkohet nga bizneset dhe do të ulë Informalitetin në formën e punësimit të peregjistruar.	Katër VKM u miratuan gjatë vitit 2020 me synim stimulimin e punësimit, përmes subvencionimit të bizneseve me qëllim punësimin e trajnimit e punëkërkesve të papunë. Mundësohet subvencionimi i pagave dhe kontributeve shoqërore për një periudhë maksimumi një vit sipas disa specifikave të programeve të punësimit (përfshirë trajnime edhe për personat e vetëpunësuar të interesuar): - VKM 17 datë 15.01.2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale” - VKM Nr. 348, datë 29.4.2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes nëpërmjet vetëpunësimit” - VKM Nr. 535 datë 08.07.2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të punëve publike në komunitet”; - VKM Nr.608, datë 29.07.2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes nëpërmjet punësimit të personave të dalë të papunë si pasojë e Covid-19”	Skemat e miratuara të punësimit pritet të rrisin shkallën e punësimit, si dhe të ulin nivelet e informalitetit të punësimit të peregjistruar.



Fusha e ndërhyrjes	Rekomandimi	Arritja	Impakti i pritshëm
<b>2) Konkurrueshmëria e Sektorit të Turizmit</b>			
	<p>Prioritizim dhe harmonizim në kohë, transparencë dhe konsultim i planeve lokale e kombëtare për investime publike në infrastrukturë në sektorin e turizmit. Kjo do të ndihmojë bizneset të hartojnë plane fizibiliteti dhe planifikim investimesh.</p> <p>Identifikimi dhe klasifikimi i strukturave akomoduese, siç përcaktohet në Ligjin Nr. 93/2015, përfshirë apartamente/ vila dhe bujtina, të cilat ushtrojnë veprimtari ekonomike në fushën e turizmit, përmes një fushate të koordinuar midis DPT, MTM, Bashkive.</p>	<p>MTM në bashkëpunim me institucione të tilla si Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, ka konsultuar planet lokale dhe kombëtare në fushën e turizmit, konkretisht gjatë procesit të hartimit të planeve të hollësishme të Zonave me Rëndësi Kombëtare (PDZRK) siç janë: Baks- Rrjoll, Rana e Hedhun-Port Shengjin, grykëderdhja e Ishm, Tale dhe Spille. Ky proces është në vazhdimësi edhe për planet e tjera të PDZRK (aktualisht në procesin e hartimit) si dhe çdo plan lokal ose sektorial në të ardhmen. MTM në bashkëpunim me institucione të tilla si MIE, MFE dhe AIDA, është angazhuar në botimin dhe promovimin e projekteve për investime publike në infrastrukturë, si dhe investime strategjike që kontribuojnë direkt ose indirekt në sektorin e turizmit.</p> <p>KM miratoi VKM nr. 415 dt.19.06.2019 me qëllim rritjen e formalizimit sektorit përmes bërjes të domosdoshme kategorizimin e strukturave turistike. Ky proces ka filluar nga tremujori i fundit i vitit 2019, duke përfshirë bujtinat. Për identifikimin e strukturave të akomodimit të apartamenteve, një draft është përgatitur për regjistrimin dhe kategorizimin e tyre gjatë vitit 2020. Aktualisht janë kategorizuar gjithsej 1178 struktura akomodimi në mënyrë specifike: 13 Resortet; 780 hotele; 15 qendra kuruese; 70 Spitale; 20 motele; 256 Shtrat dhe Mëngjes; 14 shtretër; 10 kampingje</p>	<p>Përfitues nga këto masa janë 20,180 biznese që operojnë në sektorin e Turizmit në shërbimet e akomodimit duke përmirësuar konkurrencën dhe duke zbatuar zyrtarizimin në sektor. Turizmi aktualisht përbën rreth 15% të të gjithë sektorit të shërbimeve dhe 11% të të gjithë aktivitetit ekonomik në Shqipëri, regjistron një kontribut të drejtpërdrejtë prej 8.5% të PBB-së, punëson rreth 7.7% të forcës së punës në Shqipëri dhe mbulon 7.5% të investimeve në vend.</p>

Fusha e ndërhyrjes	Rekomandimi	Arritja	Impakti i pritshëm
<b>3) Avancimi i reformës së Deregullimit</b>			
<b>Përmirësimi i platformës online E-leje</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Saktësimi i afateve për miratimin e lejes së ndërtimit (ditët kalendarike vs ditët e punës).</li> <li>- Pezullimi i veprimtarisë së platformës të bëhet vetëm në baza ligjore.</li> <li>- Finalizimi i bazës elektronike të të dhënave për institucionet e ndërlidhura në platformë.</li> <li>- Thjeshtimi i procedurës për ndërtimet për të cilat ndikimi në mjedis është i ulët.</li> </ul>	<p>Ndërhyrjet janë bërë bazuar në ndryshimet ligjore dhe rregullatore në drejtim të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve online të siguruara përmes platformës elektronike për lejet e ndërtimit (lejet elektronike) nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- specifikimi i afateve për vendimmarrjen për lejet e ndërtimit (ndryshimi i nenit 44 pika 2 të Ligjit 42/2019),</li> <li>- shmangia e pezullimit të funksionalitetit të platformës (aktualisht AZHT është autoriteti i vetëm që miraton pezullimin),</li> <li>- thjeshtimi i lejes mjedisore për ndërtimet me ndikim të ulët në mjedis (Ligji i miratuar nr. 52/2020 "për ndryshimet e ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011" Për lejet mjedisore ",</li> <li>- përcaktimin e roleve dhe përgjegjësisë të institucioneve të ndërlidhura në platformë.</li> </ul>	<p>Këto ndërhyrje thjeshtojnë procesin e dhënies së lejeve të ndërtimit për sa i përket procedurave dhe kohës. Ai synon gjithashtu të përmirësojë renditjen e Shqipërisë në raportin e të bërit biznes për këtë vit në krahasim me 2019 (duke qenë një nga faktorët kryesorë për të rritur vlerësimin).</p>
<b>4) Incentivimi përmes stimujve fiskalë</b>			
	<p>Subvencionimi i naftës për fermerët: Përgatitja e një analize kosto -përfitimi për buxhetin e shtetit dhe fermerin, në lidhje me subvencionimin e çmimit të naftës. Argumentet në mbështetje të kësaj lidhen me (i) përdorimin e këtij instrumenti për të promovuar formalizimin e fermerëve, (ii) mbështetjen për investimet e fermerëve, (iii) pothuajse të gjitha vendet në rajon e zbatojnë një instrument të tillë</p>	<p>Me miratimin e projekt-buxhetit për vitin 2021, qeveria ka siguruar një fond prej 10 milion dollarësh, të mjaftueshëm për të subvencionuar naftën fermerëve të regjistruar përmes një NIPTi, që duke filluar nga Janari 2021 do të aplikojnë online përmes portalit e-Albania duke deklaruar emrin dhe specifikat e biznesit të tyre si sasia e tokës në pronësi ose me qira, lloji i mbjelljes, etj.</p>	<p>Këto ndryshime ligjore, ndikojnë 47 deri në 70 mijë fermerë që operojnë në këtë sektor e që pritet të regjistrohen për subvencionin duke u dhënë atyre më shumë hapësirë për të ulur kostot e aktivitetit bujqësor dhe për të rritur investimet në bujqësi.</p>

Fusha e ndërhyrjes	Rekomandimi	Arritja	Impakti i pritshëm
<b>5) Forcimi i sektorit BPO</b>			
<p>- Forcimi i ABSA (Shoqata Shqiptare e Shërbimeve të Biznesit) dhe rritja e rolit të saj dhe / ose shoqatave të tjera që kanë interes në sektori për të ulur informalitetin në bashkëpunim me institucione të tjera shtetërore</p> <p>- skanimi i sektorit, saktësimi i të dhënave të tij dhe modeli i bashkëpunimit ndërmjet arsimit dhe formimit profesional me sektorin privat</p> <p>- Krijimi i një platforme në internet për të mbështetur biznesin në kërkesat për personel, promovimin dhe stimulimin e sektorit</p>	<p>-Shoqata e sektorit BPO ndryshoi emrin e saj nga Albania Outsourcing Association në Albanian Business Services Association (ABSA). ABSA ka përfshirë në anëtarësimin e saj jo vetëm qendra shërbimesh online por edhe biznese që ofrojnë shërbime me vlerë të shtuar si psh marketing dixhital. ABSA ka zhvilluar takime të rregullta me përfaqësues të bizneseve në sektorin e BPO dhe institucioneve shtetërore si Inspektorati i Punës dhe sindikata e punonjësve, të cilat janë finalizuar me kontratën e parë kolektive në sektorin e BPO dhe konkretisht në fushën e call center (shumë problematike për sa i përket informalitetit). Kjo ka bërë të mundur përmirësimin e marrëdhënieve punonjës-punëdhënës.</p> <p>- Gjatë vitit 2020, u krijua sindikata e punonjësve të qendrave të shërbimeve (call center) - 'Solidariteti'.</p> <p>- ABSA në bashkëpunim me AIDA ka hartuar dhe botuar broshurën "BPO në Shqipëri", dhe në bashkëpunim me shoqatën AITA dhe Risi Albania realizuan botimin e broshurës "Albania Your Next Nearshore ICT Destination".</p> <p>- Përpunimi i platformës në internet "Global Digit City" në të cilën bëhet promovimi i Bizneseve dhe aftësive dixhitale në bashkëpunim me Bashkitë e Korçës dhe Shkodrës për të mundësuar zhvillimin e aftësive dixhitale dhe krijimin e sa më shumë vendeve të punës në sektorë të ndryshëm. Kjo platformë bashkon investitorë, biznese, përfaqësues të shtetit, të rinj që duan të integrohen dhe zhvillojnë aftësitë e tyre dixhitale.</p>	<p>Përmes këtyre masave, u krijuan 600 vende të reja punësimi dhe raste të problematikave të punonjësve u trajtuan nga sindikata e punonjësve dhe avokatit për të drejtat e njeriut.</p> <p>Platforma e krijuar dhe e bërë aktive për dy qytete po popullohet edhe për qytete të tjera.</p>	

Fusha e ndërhyrjes	Rekomandimi	Arritja	Impakti i pritshëm
<b>6) Përputhshmëria rregullatore</b>			
	<p>(i)Përfundimi i kuadrit ligjor për sektorin e energjisë së rinovueshme (Miratimi i Metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë së prodhuar nga fotovoltaike (prodhuesit e konsumatorit)</p> <p>(ii) Fokusim në krijimin e kushteve rregullatore për shërbime cilësore në fushën e komunikimeve elektronike (broadband / 5G)</p>	<p>U aprovua metodologjia për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë së prodhuar nga fotovoltaike përmes vendimit të Bordit Rregullator të Energjisë Nr. 234, datë 20.12.2019, përmes disa shtesave në "Rregulloren për lidhje të reja me sistemin e shpërndarjes"</p> <p>VKM Nr. 434, datë 3.6.2020 "Për miratimin e planit kombëtar për zhvillimin e qëndrueshëm të infrastrukturës dixhitale me bandë të gjerë 2020-2025"</p>	
<b>8) Transparencë e incentivave</b>			
	<p>Përgatitja dhe botimi nga AIDA i informacionit të konsoliduar, lehtësisht i arritshëm për investitorët, për të gjitha incentivat, si të përgjithshëm ashtu edhe sektoriale.</p>	<p>-Inventari i incentivave ka përfunduar dhe vazhdon të përditësohet. Edhe në kuadrin e angazhimeve të MAP REA, inventari i incentivave po përshtatet në një format të caktuar.</p> <p>- Baza e të dhënave e integruar e pasurive publike nga MFE është e publikuar dhe e arritshme. Baza e të dhënave quhet Sistemi Elektronik i të Dhënave të Pronave të Shtetit.</p> <p>- Broshura promovuese janë hartuar dhe botuar në faqen eeb të AIDA për sektorë të ndryshëm (<a href="http://aida.gov.al/sektoret/">http://aida.gov.al/sektoret/</a>)</p> <p>- AIDA ka përgatitur një udhëzues për lejet / liçencat / autorizimet në Republikën e Shqipërisë, e cila përditësohet vazhdimisht.</p>	<p>Lehtësim i marrjes së informacionit për investitorët potencial.</p>

Fusha e ndërhyrjes	Rekomandimi	Arritja	Impakti i pritshëm
<b>7) Mbështetja e teknologjisë dhe inovacionit</b>			
<p>-Rritja e aksesit të NVM-ve në TIK, përmes hartimit të politikave specifike qeveritare që përqendrohen në nevojat specifike të NVM-ve. Thjeshtimi dhe koordinimi më i mirë i informacionit mbi projektet evropiane (unifikim në një portal të vetëm) me nevojat e NVM-ve lokale</p> <p>-Saktësimi dhe harmonizimi i të dhënave statistikore kombëtare duke iu referuar nivelit të përdorimit dhe aksesit të TIK nga bizneset.</p> <p>- Rritja e ekspozimit të popullsisë ndaj potencialeve të TIK përmes bashkëpunimeve me bizneset për të subvencionuar kostot e pajisjeve dixhitale si laptopë, telefona inteligjentë etj.</p> <p>- Për të rritur aftësitë në këtë sektor, nevojiten paketa trajnimi falas në internet dhe certifikatat përkatëse në trajnimin dixhital, sipërmarrjen, edukimin financiar, të rinjtë dhe gratë, etj.</p>	<p>-Me mbështetjen e BERZH-it një platformë e re e unifikuar që përmban informacione për të gjitha grantet dhe skemat e financimeve për NVM-të, pritet të finalizohet në Prill 2021.</p> <p>- një analizë dhe vlerësim i thellë i statusit të dixhitalizimit të biznesit në NVM-të shqiptare dhe rekomandimet për përmirësime po kryhen aktualisht nga një grup ekspertësh</p> <p>- është ngritur një grup pune me përfaqësuesit e MFE-MIE-MASR për të punuar në këtë drejtim. Ndërkohë ka pasur iniciativa nga biznese private të tilla si Vodafon Albania Iniciativa REDforKIDS – që dhuruan 15000 pajisje elektronike dhe 15000 karta për fëmijët e familjeve në nevojë. Unicef Albania ka kontribuar me 500 tableta dhe gjithashtu ka mbështetur krijimin e platformë online të të mësuarit www.akademi.al, e cila është falas për çdo student dhe mësues (aktualisht funksionon që nga maji i vitit 2020). Për më tepër, rreth 500 copë pajisje dixhitale janë siguruar nga kompania "Ecolog International".</p> <p>- Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (NAEVTQ) ka krijuar një strategji ku trajnimi për rritjen e aftësisë dixhitale është një pjesë integrale. Në bashkëpunim me GLZ u përgatit një studim me titull "Një studim për mbështetjen e Ofruesve Publikë të Arsimit Formimit Profesional, duke aplikuar zgjidhje dixhitale" dhe gjithashtu nga e njëjta mbështetje është duke u zhvilluar një "Udhërrëfyes për dixhitalizimin në VET". Me mbështetjen e ETF, Instrumenti EU SELFIE, u pilotua në 5 shkolla profesionale, për të matur efektin e dixhitalizimit në drejtim të udhëheqjes, mësimdhënies, vlerësimit të studentëve, etj. Gjithashtu, në kushtet e pandemisë, me mbështetjen e donatorëve të ndryshëm, janë zhvilluar trajnime të mësuesve për aftësim dixhital, veçanërisht në përdorimin e platformave të ndryshme në mënyrë që të zhvillohet procesi i të mësuarit në shtëpi.</p>	<p>Aksesi në financa për bizneset do të thjeshtohet duke pasur një platformë të unifikuar ku ata marrin informacion mbi mundësitë e financimit.</p> <p>Përmes këtyre iniciativave stimuluese, problemi i mungesës së aftësive të kualifikuara të fuqisë punëtore në sektorin e TIK mund të zgjidhet pjesërisht.</p>	

## SFIDA DHE LIMITIME

**N**ga aktivitetet e monitorimit të kryera gjatë këtij viti, një nga problematikat kryesore ka qënë limitimi i komunikimeve e takimeve direkte me institucionet zbatuese si pasojë e pandemisë Covid-19. Përtej kësaj, të tjera sfida përmendim:

- (i) Disa institucione përgjegjëse nuk reagojnë ose nuk përgjigjen formalisht në lidhje me rekomandimet e adresuara atyre.
- (ii) Për strategjitë, politikat, incentivat apo planet e veprimit të zbatuara nga institucionet qeveritare, nuk gjenden dokumente të publikuara mbi impaktin që ato kanë patur në sektorin privat.
- (iii) Disa nga rekomandimet kërkojnë shumë kohë për t'u përmbushur nga institucionet zbatuese dhe kjo ndikon në rëndësinë dhe ndikimin e tyre në komunitetin e biznesit.
- (iv) Ndryshimet e zbatuara nga institucionet përgjegjëse promovohen zakonisht në mediat sociale dhe vizive, por dokumentacioni zyrtar mbi masat e veprimet e marra, publikohet vonë ose nuk publikohet fare.



## SHTOJCA 1

### Lista e Dokumentave të konsultuara:

- **VKM 17 DT 15.01.2020** “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale”
- **VKM Nr. 348, datë 29.4.2020** “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes nëpërmjet vetëpunësimit”
- **VKM Nr. 535 datë 08.07.2020** “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të punëve publike në komunitet”;
- **VKM Nr.608, datë 29.07.2020** “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes nëpërmjet punësimit të personave të dalë të papunë si pasojë e COVID-19”
- **Ligji nr. 52/2020** “Per disa ndryshime ne ligji nr. 10448, date 14.07.2011 “Per lejet e mjedisit”, i ndryshuar
- **Vendim i ERE Nr. 234, Datë 20.12.2019** “Mbi miratimin e disa shtesave në rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes.
- **VKM Nr.434, datë 3.6.2020** për miratimin e planit kombëtar për zhvillimin e qëndrueshëm të infrastrukturës dixhitale broadband 2020–2025
- **“Komunikim mbi procesin e integritetit – një perspektivë e besueshme për Ballkanin Perëndimor”-** Komisioni European, 2020
- **Vendim Nr. 413, datë 19.6.2019** për miratimin e “Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019 - 2023 dhe Plani i saj i Veprimit”,
- **Vendim nr.279, datë 7.4.2020** “Për një shtesë në VKM nr.926, dt 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, të ndryshuar
- **Vendim nr 351 dt.29/05/2020** i ministrit të MSHMS, “Për marrjen e masave të veçanta dhe kufizimeve për parandalimin e përhapjes së Covid 19”.
- **VKM nr. 415, dt 19.6.2019** “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr 730 dt. 20.10.2016, “Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese”, të ndryshuar.
- **Ligj Nr. 84/2019** “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, dt 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar
- **Ligj Nr. 55-2020 Dt. 30.04.2020** “Për Shërbimin e Pagesave”
- **Ligji nr. 20/2020** “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”

- **“Manuali i investimeve strategjike”**, AIDA
- **“Fondi i Inovacionit”**, AIDA
- **“Shqipëria- vend i oportuniteteve”** AIDA
- **“BPO në Shqipëri – një rast biznesi tërheqës”**, AIDA, RISI Alb, ASA, FIAA

### List of Institutions periodically contacted:

- MFE
- MTM
- MIE
- MBZHR
- AIDA
- AZHT
- ASHK
- Risi Albania
- ABSA
- NAVETQ
- Instat
- Projekti Star 2 (UNDP)

### Lista e të dhënave sekondare të konsultuara:

- <https://www.konsultimipublik.gov.al/>
- <https://kryeministria.al/>
- [www.akademi.al](http://www.akademi.al),
- [www.vodafone.com](http://www.vodafone.com)
- <https://qbz.gov.al/>
- <http://aida.gov.al/sq/> (platformat FB, Instagram)
- <https://www.parlament.al/Projektligje/IndexList>
- <https://invest-in-albania.org/>
- <https://www.ashk.gov.al/> (platformat FB, Instagram)
- <http://www.azht.gov.al/> (platformat FB, Instagram)
- <https://globaldigitalcity.com/>
- <https://www.financa.gov.al/> (platformat FB, Instagram)
- <https://www.infrastruktura.gov.al/> (platformat FB, Instagram)
- <https://arsimi.gov.al/> (platformat FB, Instagram)
- <https://bujqesia.gov.al/> (platformat FB, Instagram)
- <https://shendetesia.gov.al/> ( platformat FB, Instagram)
- <https://turizmi.gov.al/> (platformat FB, Instagram)
- artikuj në Balkan Web, News 24, Exit.Al etj



Albania  
Investment  
Council

Improving Transparency and Investment Climate

[www.investment.com.al](http://www.investment.com.al)

KËSHILLI I  
INVESTIMEVE

# RAPORT MONITORIMI I REKOMANDIMEVE